



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:063367

Datë: 03.01.2025

Numri i dokumentit: 06677850

P.nr.241/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- Divizioni Penal, me Gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi-Muçaj, në çështjen penale kundër të pandehurit G.Q, nga Peja, për shkak të veprës penale “Vjedhje e rëndë” nga neni 315 paragrafi.2 pika 2.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës nën shenjën PP/II.nr.279/2024, të datës 20.03.2024, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar, të mbajtur me datën 25.12.2024, në prezencën e prokurores së shtetit Lumturije Hoxha, të pandehurit G.Q, mbrojtëses së tij av.Valbona Berbati, nga Peja, e caktuar sipas detyrës zyrtare, me datën 27.12.2024, morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 03.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

G.Q, i lindur me datë, në Pejë, nga babai H. dhe nëna B., e gjinisë, me vendbanim në rrugën “.....”,, nr., Kati, në Pejë, i pa martuar, ka të kryer një (1) vit të shkollës fillore, me profesion, i gjendjes se dobët ekonomike, nuk posedon numër telefoni, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, i lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

Me datë 09.01.2024, rreth orës 10:40 min në rr. “.....” K. Pejë, pikërisht në marketin “.....” i pandehuri, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, ia merr pasurinë e luajtshme pronë e të dëmtuarit “.....” në Pejë, në atë mënyrë që i pandehuri shkon në vendin e lartcekur nga aty në arkën në të cilën bëhen pagesat e konsumatorëve, vjedhë arkën e qelqit e cila arkë ishte e destinuar për grumbullimin e mjeteve financiare për qëllime fetare e në të cilën kishte para të imta në vlerë rreth 50 €, dhe më pas largohet nga vendi i ngjarjes pa u vërejtur nga askush, mirëpo me pastaj identifikohet nga policia.

- Me çka ka kryer veprën penale “*Vjedhje e rëndë*“ nga neni 315 par.2 pika 2.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 49, 69, 70, 71, 72 dhe 315 par.2 pika 2.2 të KPRK-së dhe neneve 242, 364, 449, 450, 452 par.4 dhe 460 të KPPRK-së, të akuzuarin:

G J Y K O N

- I. Me DËNIM ME KUSHT, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda afatit të verifikimit prej dy (2) vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.
- II. Gjukata mund ta revokon dënimin me kusht me burgim nëse i pandehuri gjatë kohës së verifikimit në kohëzgjatje prej dy (2) vitesh, duke filluar nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë kryen një apo më shumë vepra penale.
- III. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej tridhjetë (30) euro, si dhe në bazë të nenit 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej njëzetë (20) euro, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. I dëmtuari E.G , nga Peja, Lagjia, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshme, me datën 20.03.2024, ka ngrit aktakuzën nën shenjen PP/II.nr.279/2024, ndaj të pandehurit G.Q, nga Peja, për shkak të veprës penale “*Vjedhje e rëndë*” nga neni 315 paragrafi 2 pika 2.2 të KPRK-së.

Gjukata me datën 25.12.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurores të Shtetit Lumturije Hoxha, të pandehurit G.Q, si dhe mbrojtëses së tij av.Valbona Berbati nga Peja, e caktuar sipas detyrës zyrtare.

Gjukata fillimisht bazuar në nenin 56 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK – së, në të cilin parashihet se: “*I pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste: nga momenti i marrjes në pyetje për herën e parë për veprë penale të dënueshme me të paktën pesë (5) vjet burgim*”, i ka caktuar të pandehurit mbrojtësin sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.

Në këtë seancë, pasi që gjykata të pandehurit i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në procedurën penale sipas KPPRK-së, i njëjti ka deklaruar së i ka kuptuar këto të drejta dhe se është i gatshëm të vazhdohet me seancën.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores të Shtetit, gjykata, e ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimit apo mospranimit të fajësisë, dhe pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar këto të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast pasi që i pandehuri G.Q, ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije *e pranon fajësinë*, për veprën penale që i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale “*Vjedhje e rëndë* “ nga neni 315 par.2 pika 2.2 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim.

Pas deklarimit të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë, gjykata ka marrë mendimin e palëve në procedurë me ç ‘rast, Prokurori i Shtetit Lumturije Hoxha, ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë i cili pranim gjen mbështetje edhe në provat materiale të lëndës dhe i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*. Po ashtu, mbrojtësja e të pandehurit G.Q, av.Valbona Berbati, ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim i njëjti është bërë në konsultim me mua si mbrojtëse dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtit ti aprovohet*.

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje te lirë të vullnetit të të akuzuarës pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti i hetuesit policor B. K. #11823 i dt. 09.01.2024, Raport informues i dt. 09.01.2024 i përpiluar nga hetuesi K.K. #6174, Deklarata e të pandehurit G.Q e dhënë në Stacionin Policor ne Pejë me dt.11.01.2024, Deklarata e dëshmitarit A.B. e dhënë në Stacionin Policor ne Pejë me dt.09.01.2024, Deklarata e të dëmtuarit E.G. e dhënë ne këtë Prokurori me dt.23.02.2024*. Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prokurorja e Shtetit Lumturie Hoxha, lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese ka deklaruar se: *sa i përket rrethanave lehtësuese i propozoj gjykatës që të marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ndërkaq sa i përket rrethanave rënduese, këtë ia lë gjykatës në vlerësim, mirëpo duhet ta këtë parasysh se parat e vjedhura janë të bashkësisë Islame dhe të njëjta i ka shfrytëzuar për blerjen e narkotikeve dhe cigareve.*

Mbrojtësja e të pandehurit G.Q, av.Valbona Berbati, ka deklaruar se: *sa i përket rrethanave lehtësuese pranimin e fajësisë e po ashtu edhe gjendjen shumë të rëndë ekonomike, i njëjti jeton vetëm.*

I pandehuri G.Q, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale të cilën e kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të tilla.*

Andaj, me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Vjedhjes së rëndë” nga neni 315 par.2 pika 2.2 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur së të i pandehuri ka ekzistuar dashja që vepra penale të kryet në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer penale dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Para se të vendoset mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, për të akuzuarin G.Q. Gjkata në rastin konkret për të pandehurin e lartcekur si rrethana lehtësuese gjeti pranimin e tij të fajësisë dhe shprehjen e keqardhjes pranë gjykatës për veprën e kryer penale, si dhe premtimin që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, gjendjen e dobët ekonomike dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar. Në anën tjetër, si rrethana rënduese gjykata mori parasysh peshën e veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit shoqëror që paraqesin këto vepra penale edhe motivin e kryerjes së veprës penale që ka qenë motivi financiar, ku pa mëdyshje e ka ditur se veprimet e tij janë të kundërligjshme (përbëjnë vepër penale), mirëpo motivi i tij i përfitimit material i ka tejkaluar ato.

Gjkata në bazë të rrethanave të lartë-theksuara, të akuzuarit i shqiptoi dënimin sikurse u theksua në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ardhur në përfundim se me këtë dënim të shqiptuar, do të arrihet efekti preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të përmbahet nga këto veprime/kryerja e veprës-veprave penale të këtilla. Gjkata në rastin konkret ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me

peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprave penale të cilat i ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të kryej veprime të ndaluara - përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprat e kryera penale, të bëj ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Vepra penale e “*Vjedhjes së rëndë*” e paraparë me nenin 315 të KPRK-së, e kualifikuar me paragrafin 2, ligjvënësi përmes këtij inkriminimi ka përcaktuar rastet kur vjedhjet marrin karakter të veprës penale të rëndë për shkak të vlerës së sendit të luajtshëm të vjedhur ose për shkak të vetive specifike të sendit ose për shkak se sendi shërben për qëllime të caktuara, e për këtë arsye kualifikohet si formë e cilësuar e veprës penale vjedhja e rëndë. Në rastin konkret objekt i këtij gjykimi kemi të bëjmë me vjedhje të rëndë sipas nenit 315 par 2 nënpar 2.2 të KPRK-së, kur shprehet se në nënparagrafin 2 të paragrafit 2 të këtij neni është paraparë *pasuria e vjedhur shërben për qëllime fetare ose është vjedhur nga ndërtesa fetare apo ndërtesa tjetër që shërben për mbajtjen e ceremonive fetare*. Ndërkaq, neni 315 par.2 i KPRK-së, përcakton minimumin dhe maksimumin e dënimit, dënim me burgim *prej tre (3) deri në shtatë (10) vjet*, ku pastaj gjykata duke u mbështetur në rrethanat e rastit konkret bëri individualizimin e dënimit për të pandehurin.

Përcaktimi i dënimit me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 1 viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në periudhë verifikuese prej 2 viteve për të pandehurin u bë duke e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit e pastaj, duke vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke zbatuar nenin 71 pika 1.3 të KPRK-së, i cili përcakton se Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit “*në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë*” dhe nenin 72 par.1 pika 1.3 të KPRK-së, pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës penale për të gjitha veprat penale, andaj mbi këtë fakt gjykata pranimin e fajësisë e mori si bazë për zbutjen e dënimit. Zbutja e dënimit u bë në kuadër të mundësive të përcaktuara më ligj, pasi që neni 72 par.3 pika 1.3 ka paraparë “*nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim*”.

Gjykata të pandehuri i ka shqiptuar dënimin e përcaktuar si në dispozitiv konform nenit 48 par.1 dhe 2 të KPRK-së, i cili përcakton se: “*1. Gjykata mund t’ia shqiptojë kryesit dënimin me kusht në përputhje me dispozitat e këtij Kodi*”. Ndërkaq par.2. përcakton se: “*Me dënimin me kusht, gjykata ia cakton kryesit të veprës penale dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit dhe as më*

e gjatë se pesë (5) vjet”. Ndërsa neni 49 par.2 i KPRK-së, përcakton se: “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit”.

Vendimin mbi zëvendësimin e dënimit me kusht në dënim burgimi në rast se i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen veprë tjetër penale u mor në përputhje me nenin 50 par. 1 dhe 2 të KPRK-së.

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 449 par.1 dhe par. 2 dhe nenit 452 par. 1 të KPPRK-së, e ngarkoi të pandehurin me shpenzimet e procedurës, të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar prej fillimit të kësaj procedure e deri në përfundimin e saj, e po ashtu konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të cilat obligohet ti paguajë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit E.G., nga Peja, Lagjia, për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 457 dhe nenit 462 par.2 të KPPRK-së, andaj gjykata ka vendosur si në pikën e VI të dispozitivit të këtij aktgjykimit.

Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL
P.nr.241/24, me datë 03.01.2025.

Bashkëpunëtore profesionale:

Leonita Lajçi Muçaj

Gjyqtarja vetme gjykuese

Blerta KELMENDI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë, në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita kur palët e pranojnë aktgjykimin me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për palën dhe gjykatën.